

KONTRATË PËR FURNIZIM TË DERIVATEVE ME PAKICË PËRMES KARTELAVE

Kjo Kontratë është lidhur më 17.10.2023

NË MES

"Ex Fis" Shpk, Bulevardi Bill Clinton AB7, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, numri i regjistrimit të biznesit 70272163 dhe fiskal 600090328, përfaqësuar nga Genc Bajrami, Menaxher i shitjes, i referuar në vijim si Ex Fis;

DHE

Sindikata e Policise se Kosovës, numri i regjistrimit 600595899, i referuar në vijim si Blerësi;

KONTRATA KU PALËT JANË DAKORDUAR NË VIJIM

Neni 1 – Subjekti i Kontratës

Kjo Kontratë rregullon marrëdhëniet e Ex Fis dhe Blerësit për furnizimin me pakicë të derivateve përmes debit kartelave në të gjitha pikat e Ex Fis në Kosovë.

Neni 2 – Procedura për Pranimin e Kartelave

Blerësi duhet të plotësoj formularin me informatat e kërkuara që është pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, në mënyrë që të pajiset me kartelë/a.

Pas nënshkrimit të Kontratës, Ex Fis do të bëjë dorëzimin e kartelave.

Për modifikimin eventual të strukturës së kartelave (shtimin, ndryshimin, deaktivizimin), Ex Fis do të jetë në shërbim aktiv të Blerësit.

Neni 3 – Forma e Kartelave

Secila kartelë do të ketë numrin e vet serik unik dhe do të jetë e enkriptuar. Kartelat do të kenë formën dhe dizajnin si në vijim:



Neni 4 – Procedura e furnizimit

Mbajtësi i kartelës do të jetë personi i autorizuar i Blerësit për furnizim.

Vetëm pas skenimit dhe vërtetimit në databazën kryesore të Ex Fis se kartela është valide, do të mund të filloj furnizimi i automjetit me derivate.

EXFIS



Neni 5 - Çmimi

Çmimi i shitjes do të jetë çmimi ditor zyrtar i shitjes për pikën në të cilën realizohet furnizimi, duke aplikuar zbritjen prej _____ | per litër.

Neni 8 – Reklamimet

Blerësi do të ketë afat 7 ditë nga data e pranimit të faturës të paraqes reklamime / komente eventuale në faturën e pranuar. Reklamimet / komentet do të dërgohen vetëm në formë të shkruar, me ç'rast Ex Fis do të jetë në shërbimin e Blerësit për identifikimin e furnizimeve.

Në çoftë se Ex Fis nuk pranon koment me shkrim deri në 7 ditë nga data e pranimit të Faturës, atëherë Fatura do të konsiderohet se nuk ka reklamime.

Mostrat e derivateve mund të mirren nga pikat tona dhe të testohen. Nje mostër mbetet tek ne dhe nje mirret nga ana e blerësit.

Neni 7 – Kushtet e pagesës

Pagesa do të realizohet cash pas çdo furnizimi.

Neni 8 – Validiteti i Kontratës

Kjo Kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të jetë valide në afat të pacaktuar.

Të dy palët kanë të drejtë ta shkëpusin Kontratën përmes njoftimit me shkrim së paku 15 ditë para datës së shkëputjes.

Neni 9 – Komunikimi

Komunikimi me Ex Fis në lidhje me këtë Kontratë do të realizohet përmes:

Emri/Mbimri: Genc Bajrami, Telefoni: +383 44 974 424, Email: genc.bajrami@exfis.com.

Emri/Mbimri: Avdi Hoti, Telefoni: +383 49 718 700, Email: avdi.hoti@spk-rk.eu

EX FIS (LËSHUESI I KARTELAVE)

Emri/Mbimri: Genc Bajrami

Nënshrimi:

Vula:



BLERËSI (PRANUESI I KARTELAVE)

Emri/Mbimri: Avdi Hoti

Nënshrimi:

Vula:

